

Programi i automjeteve

A dëshiron të provosh të punosh që nga koha e gjimnazit?

A dëshiron të punosh në një lëmi që rritet dhe ndryshon?

A dëshiron të zhvillosh interesimin tënd për automjete?

A dëshiron të punosh menjëherë pas gjimnazit?

A dëshiron të mësosh me tepër në lidhje me çështje shumë të flakta te debatet për ambientin?

Në atë rast, Programi i automjeteve mund të jetë për ty.

Te Programi i automjeteve dot të jepet mundësia që të ndreqësh automjete dhe të mësosh se si të përdorësh automjetet për shërbime të llojeve të ndryshme. Mundesh për shembull të bëhesh vozitës i vinçave, vozitës i karburanteve ose diçka që të intereson ty. Mendo sa shumë ndikohet jeta yte e përditshme nga automjete të llojeve të ndryshme! Atëherë do e kuptosh se sa e gjërë është lëmia dhe se sa drejtime që ekzistojnë në këtë lëmi.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e automjeteve mund të kërkoh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur. Mund të zgjedhësh t'i vazhdosh studimet. Ndoshta vazhdon në fakultet, ose ndoshta e zgjedh një kualifikim të mëtjshëm te Fakulteti i profesioneve.

Nëse e di që tani se dëshiron t'i vazhdosh studimet, mund të pyesësh udhërrëfyesen e studimeve dhe të profesioneve se cilat kurse do të duhet të zgjedhësh që të keshë mundësi të pranohesh te kualifikimi yt.

Nëse dëshiron të punosh në lëminë e automjeteve, do të keshë mundësi të mira që të mësosh më tepër në lidhje me punën tënde ose lëminë tënde, pasi që lëmia zhvillohet kaq shumë.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që e përfundon Programin e automjeteve mundesh për shembull të kërkoh punë si ofiçioinist, ilustrues, teknik i kamionëve, vozitës i vinçave, teknik i rrotave, teknik i maqinerisë, vozitës i transprteve speciale, vozitës i tresnprteve pyllore, vozitësi i karrocave ose mekanik aeroplanesh.

Përmbajtja e Programit

Programi i automjeteve përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë veçanta për Programmin e automjeteve. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej katër drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin e automjeteve në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimitet. Në disa

vende mund të ketë edhe me tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimet kombëtare janë:

- Teknikë aeroplanesh – për ty që dëshiron të mirëmbajsh dhe të riparosh aeroplane, ose që do të keshë një kualifikim teknik të gjërë që të jep mundësi punësimi në shumë lëmi
- Karroceri – për ty që dëshiron të riparosh dëmitime automjesh ose të rindërtosh dhe të i llakosh automjetet
- Teknikë e kamionëve dhe të maqinerisë – për ty që dëshiron të mirëmbajsh dhe të riparosh automjete të rënda, si për shembull kamionë, autobuzë dhe makinat e bujqësisë, ose që dëshiron të punosh me motroçikleta apo automjete dhe makina të vogla
- Teknikë e makinave personale – për ty që dëshiron të mirëmbajsh dhe të riparosh makinat personale
- Transport – për ty që dëshiron të punosh te lëmia e transporteve.

Kontake me tregun e punës

Te Programi i automjeteve do të kesh kontakte me tregun e punë që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Do të jepet mundësia të keshë kontakte edhe me sipërmërraës të vegjël dhe të mëdha që mirren me drejtime të ndryshme. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Ka mundësi të mira që të punësohesh në lëminë e automjeteve, gjithashtu edhe menjëherë pas kohës së gjimnazit. Nëse bëhte lehtë apo vështirë për ty që të pranohesh në punë, varret nga për shembull drejtimin që e keni kryer. Sasia e punë varret poashtu edhe nga zhvillimi në pjesën tjetër të shoqërisë. Për shembull te lëmia e transporteve, gjatë viteve të fundit ka pasur mundësi të mira për punësim. Por te për shembull industria e prodhimeve tash për tash ka shumë të papunësuar.